

Platformat e punës operative, baza ligjore për krijimin, organizimin e veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit

Prof. asc. Dr. Albert Nikolla

Grupi i punës: Adela Toporja, Jonel Hibo, Liljana Cocoli, Mirela Lame

Bio

Albert P. Nikolla është anëtar i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit që prej Qershorit të vitit 2022. Ai ka një formim të thelluar në fushën e antropologjisë kulturore dhe përvojë të gjerë në administratën publike dhe në shoqërinë civile. Formimi i tij akademik ndërthur filozofinë, etikën politike dhe antropologjinë, fusha në të cilat ka zhvilluar kërkime të fokusuara mbi ndikimin e ideologjive totalitare në shoqërinë shqiptare, mbi figurën e “njeriut të ri” gjatë diktaturës komuniste dhe sfidat e tranzicionit post-komunist. Ka përfunduar doktoratën në antropologji kulturore dhe ka qenë pedagog i ftuar në universitete shqiptare dhe të huaja, përfshirë Universitetin e Firences dhe Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës. Në 2014 ka fituar titullin Profesor i Asociuar pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike. Prof.ass. Albert Nikolla është autor i disa botimeve studimore dhe librave, si: “Njeriu i ri shqiptar, ndërmjet moralit komunist dhe krizës së tranzicionit” (Onufri, 2012), “Antropologji në MAPO” (JET Press, 2018), dhe “Lëvizja e ’68-s dhe antikultura shqiptare” (në proces botimi, 2023). Ka botuar gjithashtu artikuj mbi përndjekjen e shkencëtarëve gjatë diktaturës, ndikimin e Revolucionit Kulturor Kinez në Shqipëri, si dhe mbi rastine Musine Kokalarit si symbol i rezistencës intelektuale. Në rolin e tij si anëtar i Autoritetit, Nikolla ka marrë pjesë aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare kushtuar kujtesës historike, qasjes së studiuesve dhe gazetarëve të dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, dhe rëndësisë së vërtetimit të së kaluarës përmes dokumentacionit arkivor. Në këto forume, ai ka sjellë qasje antropologjike në analizën e traumës kolektive dhe ndërtimit të kujtesës publike në Shqipëri. Përpara angazhimit në Autoritet, ai ka mbajtur pozicione të rëndësishme në administratën shtetërore si Zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe ka shërbyer si Sekretar për Marrëdhënie me Median dhe Shoqërinë Civile në Partinë Socialiste. Ka qenë gjithashtu kryetar i Komisionit për Trashëgimi Kulturor dhe Turizëm në Këshillin Bashkiak të Tiranës dhe për disa vite drejtues i Caritas Shqipëri. Me një përvojë që ndërthur dijen akademike, përkushtimin publik dhe angazhimin për drejtësi historike, Albert P. Nikolla mbetet një zë i rëndësishëm në debatin mbi kujtesën dhe identitetin shoqëror në Shqipërinë post-totalitare.

Abstrakt

Ky studim ka për qëllim të analizojë platformat e punës operative, bazën ligjore për krijimin e organizimin e veprimtarisë të ish-Sigurimit të Shtetit, Në thelbin e tyre këto platforma kanë përcaktuar parimet e punës e të drejtimit të organeve të punëve të brendshme, me karakter agjenturial-operativ, pra mbi ngritjen e rrjetit sekret, kategoritë ndaj të cilave ushtrohej apo përjashtohesh ndjekja, etj. Platformat asnjëherë nuk u bënë dokumente shtetërore, çka nënkuptonte se kjo ishte një veprimtari që mbetej terësisht e paligjshme, në shkelje me kushtetutën dhe legjisllacionin shqiptar në vitet 1944-1990. Në qëndër të studimit do të jetë roli i bashkëpunëtorit, rekrutimi dhe klasifikimi i të cilit është rregulluar në këto platforma Nga shqyrtimi i literaturës mbi përmabjtjen e platformave rezulton se rrjeti agjenturor nuk ishte një

njësi e vogël e veprimtarisë të Ish-Sigurimit të Shtetit, por një mekanizëm i detajuar i veprimtarisë të Ish-Sigurimit të Shtetit që fillonte nga rekrutimi, mbikëqyrja, shpërblimi dhe gjykimi i tij. Rastet kur është përdorur materiali në “*formë shtrëngimi*” dhe manipulimi që është bërë gjatë procesit të rekrutimit të bashkëpunëtorit, tregojnë se procesi i rekrutimit ishte shndërruar si një instrument i sofistikuar intimidimi dhe shtrëngimi psikologjik, duke krijuar një klimë paligjshmërie, frike dhe nënshtrimi ndaj atyre që përzgjidheshin për tu rekrutuar si “*bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit*”.

Për të nxjerrë në pah këto fenomene, studimi do të përdorë një metodologji të integruar, që përfshin shqyrtimin e burimeve arkivore dhe literaturën përkatëse, krahasimin historik të platformave të fshehta të punës operative etj. Përmes kësaj metode hulumtuese synohet të evidentohen jo vetëm trajektoret e zhvillimit të rolit të bashkëpunëtorit, por edhe metodat antiligjore të përdorura gjatë proceseve të rekrutimit, të ilustruara përmes rasteve konkrete. Rastet do të japin një pamje më të qartë mbi zhvillimet që ka pësuar roli i bashkëpunëtorit në Platformat që përcaktonin funksionimin e Ish-Sigurimit të Shtetit. Pra, në thelb, analiza synon të ofrojë një panoramë terësore të rekrutimit, marrjen e deklaratave të bashkëpunimit, rolin e punonjësit operativ, klasifikimin e bashkëpunëtorit, materialin e përdorur për të tërhequr në bashkëpunim, ndëshkimin e bashkëpunëtorit, etj, pa adoptuar një qëndrim përfundimtar apo gjykues dhe duke krijuar kështu një bazë për interpretime dhe hulumtime shkencore të mëtejshme. Gjithashtu, studimi respekton standardet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e anonimatit, në përputhje me Kushtetutën, Ligjin nr. 124/2024 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” dhe Ligjin nr. 45/2015 “*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit*”.

Fjalë kyçe: *platformat e punës operative, bazë ligjore, veprimtari agjenturore, rrjeti secret.*